



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prudato Received/Delivered	01.06	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SIKIMSTICK	4570/2023		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.6092023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.609/2023 të datës 04.04.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Kuvendi i Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet pjesërisht** si e bazuar ankesa me numër A.nr.609/2023 e datës 04.04.2023 e parashtruar nga ankuesi lidhur me pretendimin ankimor për kompensimin e shtesës transitore për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023, në mënyrë retroaktive, ndërsa **Refuzohet** pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës për vëllimin e punës dhe kompensimin për punën jashtë orarit të punës.

II. **Obligohet** Drejtoria e Personelit e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ankuesit t'ia bëjë kompensimin në pagë në mënyrë retroaktive për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023 në emër të shtesës transitore.

III. **Obligohet** Sekretari i Kuvendit të Republikës së Kosovës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtë.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil i punësuar sipas Akt emërimit të datës 19.06.2017 në Kuvendin e Kosovës, në pozitën e punës Zyrtar Ligjor për Mbështetje Kryesisë së Kuvendit dhe Seancës Plenare (Zyrtar ligjor 2), më datë 04.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3281/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër organit të punësimit/Kuvendit të Republikës së Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e shtesës tranzitore, shtesës për vëllimin e punës dhe kompensimin për punën jashtë orarit të punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pretendon se institucioni punëdhënës me rastin e ekzekutimit të pagave sipas legjislacionit të ri të pagave, për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023 ka bërë shkelje të dispozitave të këtij ligji për shkak se i njëjti nuk e ka pranuar shumën e plotë në emër të pagesës për shtesën transitore sikurse i njëjti nuk është duke u kompensuar në emër të shtesës për vëllim në punë dhe kompensimit për punë jashtë orarit të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Kuvendin e Republikës së Kosovës me numër protokolli 3364/2023. Ndërsa Këshilli, me datë 26.04.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3840/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese, ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi O.SH me numër protokolli 3281/2023 të datës 04.04.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër SP.9-02/22 të datës 30.09.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.SP 7-01/22 të datës 05.07.2022 të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës; Raportin e numrit të listës së pagave për O.SH me ID numër : 100750464; Lista e pagave të O.SH për periudhën 01.03.2023-31.03.2023 të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës; Hyrje-daljet e O.SH për periudhën 01.02.2023-28.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3364/2023 të datës 06.04.2023 të dërguar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Kuvendin e Republikës së Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3840/2023 të datës 26.04.2023 të dërguar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e O.SH me numër ref. Të pozitës DÇLP-01/11-16 të datës 19.06.2017 të lëshuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar ligjor për mbështetje Kryesisë së Kuvendit dhe Seancës Plenare; Lista e Pagave të O.SH për periudhën 01.02.2023-28.02.2023 të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës; Lista e Pagave të O.SH për periudhën 01.03.2023-31.03.2023 të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës; Hyrje-daljet e O.SH për periudhën 01.03.2023-31.03.2023; Vendimin me nr.SP.7-01/22 të datës 05.07.2022 të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës; Vendimin me nr.SP.10-01/22 të datës 25.10.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.SP 7-01/22 të datës 05.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.SP.9-02/22 të datës 30.09.2022 të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës; Takimet dhe Grupet Punuese të Komisionit Ad-Hoc për Reformën Zgjedhore; Njoftimin për vones të dërguar me e-mail me datë 06.02.2023 nga O.SH për L.D; Njoftimin për daljen nga puna para përfundimit të seancës të dërguar me e-mail me datë 08.02.2023 nga O.SH për L.D; Ftesën për seancën plenare me 09.02.2023 ora 20:00 të



dërguar me e-mail me datë 09.02.2023 nga S.R për Deputetët-Legjislatura e 8; Njoftimin e dërguar me e-mail të datës 10.02.2023 nga O.SH për L.D; Njoftimin për daljen nga puna para përfundimit të seancës të dërguar me e-mail me datë 13.02.2023 nga O.SH për L.D; Njoftimin e dërguar me e-mail të datës 16.02.2023 nga O.SH për L.D; Njoftimin për daljen nga puna para përfundimit të seancës të dërguar me e-mail me datë 22.02.2023 nga O.SH për L.D; Kërkesën për regjistrat e pranisë në punë- të ndara për muajt Shkurt dhe Mars të vitit 2023 të dërguar me e-mail me datë 03.04.2023 nga L.D për O.SH; Njoftimin e dërguar me e-mail të datës 23.01.2023 nga O.SH për L.D; Njoftimin e dërguar me e-mail të datës 18.01.2023 nga O.SH për L.D; Njoftimin e dërguar me e-mail të datës 20.12.2022 nga O.SH për L.D; Njoftimin e dërguar me e-mail të datës 19.12.2022 nga O.SH për SH.SH; Njoftim e dërguar me e-mail të datës 10.01.2022 nga O.SH për L.D; E-mail lidhur me Seancën Plenare të datës 10.11.2022 ora 10:00, me datës 07.11.2022 të dërguar nga S.R për Deputetet_Legj_8; E-mail lidhur me vazhdimin e Seancës Plenare të datës 20.10.2022 ora 12:00, me datë 21.10.2022 të dërguar nga S.R për Deputetet_Ligj_8; Njoftimin e dërguar me e-mail të datës 20.10.2022 nga O.SH për L.D; Ftesën për seancën plenare të datës 07.10.2022, të dërguar me e-mail me datë 03.10.2022 nga S.R për Deputetet_Ligj_8; Njoftimin e dërguar me e-mail me datë 07.10.2022 nga O.SH për L.D; Njoftimin e dërguar me e-mail me datë 05.08.2022 nga O.SH për L.D; Listat e Pagave Mars 2023 të dërguar me e-mail të datës 26.04.2023 nga XH.Z për A.T dhe B.H; Listat e Pagave Mars 2023 të dërguar me e-mail të datës 26.04.2023 nga I.A për XH.Z; ; Listat e Pagave Mars 2023 të dërguar me e-mail të datës 04.04.2023 nga I.A për B.B; ; Listat e Pagave Mars 2023 të dërguar me e-mail të datës 15.03.2023 nga B.B për A.F; ; Listat e Pagave Mars 2023 të dërguar me e-mail të datës 15.03.2023 nga I.A për B.B; ; Listat e Pagave Mars 2023 të dërguar me e-mail të datës 14.03.2023 nga N.B për N.D, A.T dhe E.D; ; Listat e Pagave Mars 2023 të dërguar me e-mail të datës 10.03.2023 nga N.D për A.T, N.B dhe E.D; ; Listat e Pagave Mars 2023 të dërguar me e-mail të datës 10.03.2023 nga N.D për A.T, N.B dhe E.D; Kërkesën me numër protokollit 1-115/2325 të datës 12.04.2023 të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës; Njoftimin me numër protokollit 1-120/2325 të datës 13.04.2023 të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës; Vendimin ne Nr.08-V-439 të datës 07.04.2023 të lëshuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; Njoftimin e dërguar me e-mail të datës 13.04.2023 nga I.A për N.K dhe B.B.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe duke marrë për bazë legjislacionin përkatës që rregullon këtë natyrë të kësaj çështje, konstatoi se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 19.06.2017 është i punësuar në Kuvendin e Kosovës në pozitën e punës " Zyrtar Ligjor për Mbështetje Kryesisë së Kuvendit dhe Seancës Plenare (Zyrtar Ligjor 2) ", rrjedhimisht mbështetur në dispozitat e nenit 4 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ankuesi hynë në kudër të nëpunësve civil me status të veçantë, ndërsa marrëdhënia e tij e punës rregullohet, gjegjësisht trajtohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të cilin sipas mandat e miraton Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se i njëjti është dëmtuar në pagë për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023, pasi që nuk i është paguar e plotë shtesa transitorë, pas hyrjes në fuqi të ligjit për pagat në sektorin publikë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht nenin 41 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "1. Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji

përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë” dhe si rrjedhojë duke ju referuar shkresave të lëndës rrjedh se ankuesi para se të hynte në fuqi ligji i ri i pagave ka realizuar pagë më të lartë, ndërsa i njëjti pretendon se për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023 është dëmtuar në vlerën e pagës ndërmjet vlerës prej 78.68€ deri në 93.62€ (vlerë kjo e papërcaktuar në mënyrë specifike), sikurse të njëjtin fakt e pohon edhe Drejtoresha e Drejtorisë së Personelit të Kuvendit të Republikës së Kosovës se ankuesi me rastin e ekzekutimit të pagave sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka realizuar pagë më të ulët për muajin shkurt dhe mars, prandaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit ndërlidhur me mosekzekutimin e plotë të shtesës tranzitore është e bazuar dhe mbi këtë bazë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, gjegjësisht Drejtoria e Personelit të Kuvendit të Republikës së Kosovës është e obliguar të veprojë në pajtueshmëri me nenin neni 41 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik duke ia kompensuar ankuesit në mënyrë retroaktive diferencën e shtesës tranzitore për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023 (pas përlogaritjes së vlerës së saktë sipas detyrës zyrtare), ndërsa në mënyrë të njëjtë duhet të vazhdojë edhe tutje sipas afateve kohore të përcaktuara me dispozitat ligjore deri në momentin që me rregulloren e re të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës kjo çështje të rregullohet ndryshe.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik neni 28 paragrafi 7 dhe neni 37 paragrafi 8 përcaktohet se: “28. Shtesa për vëllimin e punës, 7.Kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës sipas këtij neni, në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucioneve” dhe “ 37. Kompensimi për kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës 8. Kushtet e detajuara për kompensimin sipas këtij neni, për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohen me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucionit përkatës.” ka konstatuar se lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit në rastin konkret e drejta për shtesë apo kompensim për shkak vëllimit të punës dhe kompensimi për punën jashtë orarit, rregullohet me akt të veçantë të cilin duhet ta miratojë Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës sikurse përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 4 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Këshilli me datë 26.04.2023 ka pranuar përgjigje me numër protokolli:3840/2022 nga Drejtoria e Personelit të Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes së cilës konstatohet fakti se Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ende nuk e ka miratuar Draft-Rregulloren për Strukturën organizative, Klasifikimin e Pozitave, Shtesave dhe Kompensimeve mbi Pagën bazë të Nëpunësve Civil të Administratës së Kuvendit, nga rrjedh se në rastin konkret pa miratimin e rregullores në fjalë, nga të punësuarit në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk mund të materializohet e drejta e përcaktuar për shtesa për vëllimin e punës dhe kompensimi për kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës sikurse përcaktohet në paragrafin 7 të nenit 28 dhe paragrafin 8 të nenit 37 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga rrjedh se ankesa e ankuesit e datës 04.04.2023 lidhur me pretendimin ankimor për kompensimin e shtesës për vëllimin e punës dhe kompensimin për punën jashtë orarit të punës, refuzohet si e pabazuar në këtë fazë ngase nuk është miratuar akti i veçantë nga Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes të cilës përcaktohen specifikat dhe mënyra e realizimit të këtyre shtesave.



17

Kolegji i Këshillit pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatimit të gjendjes faktike dhe analizimit të dispozitave të aplikuara për nëpunësit civil të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit e datës 04.04.2023 është pjesërisht e bazuar, nga rrjedh se pretendimi ankimor lidhur me kompensimin e shtesës transitorë për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023 në mënyrë retroaktive është i bazuar, ndërsa pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës për vëllimin e punës dhe kompensimin për punën jashtë orarit të punës është refuzuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, për shkaqet e dhëna sikurse në arsyetimin tij.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër, A.nr.609/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHIBAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Kuvendin e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së